



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.10.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti dhe Nazlije Shala

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Dhënia në debat publik e Draft dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e Komunës së Obiliqit
4. Dhënia në debat publik e Draft Planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
8. Formimi i Komisionit për shqyrtimin e Ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave lokale
9. Shqyrtimi i kërkesës nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022
10. Raporti nëntë (9) mujor financiar i shpenzimeve për vitin 2022
11. Shqyrtimi i kërkesave
12. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratu me 6 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Bajram Hashani

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 4 vota për dhe 2 vota kundër.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DSHPE-ja, për dhënie në debat publik të Draft dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për territorin e Komunës së Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord që ky Draft dokument të shkoj në debat publik, por kontributi ynë do të jepet në mbledhjen e Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord që ky Draft dokument të shkoj në debat publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal dhënien në debat publik të Draft dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për territorin e Komunës së Obiliqit.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DAP-ja për dhënien në debat publik të Draft planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që ky Draft plan të jepet në debat publik, ndërsa kontributi ynë do të jetë në mbledhjen e Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal dhënien në debat publik të Draft planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që Draft Rregullorja e cekur më lartë ti rekomandohet Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Kjo Draft Rregullore ka qenë paraprakisht, e kemi shqyrtuar dhe rekomandimi ynë ka qenë që të bashkëpunohet me prijësit e bashkësive fetare, që të jetë sa më complete. Ne shpresojmë që të japim ende kontribut në mbledhjen që do të mbahet pas 2 ditësh, kështu që jemi dakord që ti rekomandohet Kuvendit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord që ti rekomandohet Kuvendit Draft Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.

**Sami Ahmeti** – Shumë po na bëhen për mbledhjen e Kuvendit komunal. Sido qoftë edhe ne jemi dakord që kjo Draft Rregullore të shkoj në Kuvend edhe pse sa e kam kuptuar nuk i përshtatet shumë Obiliqit, më shumë është copy paste që është marrë dikund tjetër. Sido qoftë kontributin tonë do ta japim në mbledhjen e Kuvendit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DSHPE-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord që Draft Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave ti rekomandohet Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Kjo Rregullore ka qenë edhe një herë në Kuvend, që është shtye për faktin e tarifave dhe nuk pashë se ka ndryshime në Rregulloren e re. Ne jemi dakord që ta shqyrtojmë në seancën e ardhshme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Draft Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e DAP-së, për formimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave lokale.

**Enver Gashi** – Ne jemi për që ti rekomandohet Kuvendit formimi i këtij Komisioni.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi që të shkoj në Kuvend formimi i këtij Komisioni edhe pse koha e ankesave të pikave të caktuara nuk e di sa është e saktë sepse nuk e kam lexuar Rregulloren, vetëm se ka qenë dashur me u bë herën e kaluar. Gjithsesi jemi që të shkoj në Kuvend, pastaj atje, i shqyrtojmë çështjet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal formimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave lokale.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022.

**Zarife Behluli** – Siç po shihet është realizue buxheti nga të hyrat vetanake 100 %, ndërsa tejkallim kemi 213,982.70 euro. Ju njoftoj se rregullimi i parqeve nuk figuron te kërkesa e juaj, por unë do ta përgatiti kërkesën me ndryshime për Kuvend sepse për mbledhjen e KPF-së, kërkoj falje që më ka shpëtue ky gabim, por rastin e kam pasë ashtu. Ju sqaroj se pika 6, është rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit, në vlerën prej 26,924.67.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord që rritja e të hyrave vetanake të shkoj në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord mundësisht që të na vijnë këto ndryshime pasi që drejtoresha nuk ka pasë kohë me i evidentue dhe e mirëkuptojmë nëse, ka pasë rast familjar.

**Kryesuesja** – Kërkojmë nga drejtoresha që të na përsëritë kërkesën me pikën 6 të projektit, po ashtu emri i projektit dhe shuma në mënyrë që të ia dërgojmë anëtarëve të Kuvendit bashkë me rekomandime.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022.

#### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti raportin nëntë (9) mujor financiar të shpenzimeve për vitin 2022.

**Enver Gashi** – Ne jemi për që ti rekomandohet Kuvendit komunal raporti nëntë (9) mujor financiar.

**Sami Ahmeti** – Raporti financiar si zakonisht po përsëritet pa qenë mjaftueshëm të specifikuar dhe ne jemi kundër. E di që gjithsesi ky raport shkon në Kuvend, megjithatë ju kishim kërkuar që të paktën të jenë drejtorët prezentë që nëse, kemi pyetje për kategori të caktuara të na shpjegojnë për këto.

**Kryesuesja** - Patjetër z.Ahmeti edhe drejtorët sot shumica prej tyre janë prezentë përveç atyre, që kanë ndonjë takim në Ministri

Pas diskutimeve anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 4 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit komunal raportin nëntë (9) mujor financiar të shpenzimeve për vitin 2022.

#### **Pika 11 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Kryetari i Komunës për zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së, nr.6, z.Avdyl Mustafa me z.Faton Beka, si pasojë e dorëheqjes së z.Avdyl Mustafa nga pozita e kryesuesit të Komitetit për komunitete..

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 4 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesën e Kryetarit të Komunës për zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së, z.Faton Beka, në vend të z.Avdyl Mustafa, i cili ka dhënë dorëheqje

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga z.Naim Grajqevci, Kryetar i Shoqatës sindikale të administratës komunale për lejin e mjeteve financiare në shumën prej 500 euro, si pako ushqimore për të gjithë të punësuarit në administratën komunale të Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan DEFZH-së, shqyrtimin e kërkesës nga Naim Grajqevci, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për të gjithë të punësuarit në administratën e Komunës së Obiliqit, për vitin 2022 në vlerën prej 500 euro, si pako ushqimore nga mjetet e lira të ndonjë kategorie buxhetore, siç kanë vepruar edhe Komunitat tjera.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, e cila kërkon që segmenti i rr.”Dita e flamurit” në një gjatësi prej 160 m të pagëzohet me emrin “Zenun Aliu”.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan DPUKP-së për shqyrtim kërkesën nga Ganimete Aliu, që segmenti i rrugës “Dita e flamurit” me një gjatësi prej 160 m të pagëzohet me emrin “Zenun Aliu”.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Naser Sollova, për shqyrtimin e peticionit të qytetarëve për lejimin e shfrytëzimit të parkingut.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan DSHPE-së, kërkesën nga Naser Sollova për shqyrtim të peticionit të qytetarëve të ndërtesave Hyrja A1, A2 për lejimin e shfrytëzimit të parkingut.

**Sami Ahmeti** – Vetëm duhet të kuptohemi diçka, kërkesat që po vijnë po na drejtohen neve si Kuvend dhe a është komplet e ligjshme forma si po drejtohen te Drejtoritë, e pastaj ne si Kuvend nuk po kemi asnjë informacion. Unë jam shumë dakord që të shkojnë, por derisa të vijnë këtu nuk po bëhet 1 orë para se të mbahet KPF-ja, por po bëhen me javë të tëra. Derisa po vijnë kërkesat pse Drejtoritë nuk po i shqyrtojnë këto kërkesa në mënyrë që vërtetë pasi që po orinetohen qytetarët te Kuvendi, le të shqyrtohen. Unë nuk kam kurgjë që me bë joligjore, por në të njëjën kohë nuk janë edhe kërkesat e qytetarëve që bëhen që na orientohen, nuk na kushton kurgjë me i trajtue edhe në seancën e Kuvendit. Forma qysh po hudhen në anën tjetër, e pastaj ne nuk kemi asnjë informacion unë mendoj se nuk është shumë e rregulltë. Gjithsesi, është logjike kjo çka po bëhet, por tutje nuk po kemi informacion.

**Kryesuesja** – Në shumë Komuna, apo Kuvende të Komunave, kërkesat nuk adresohen fare te Kuvendi komunal sepse adresa e tyre e parë është Drejtoria përkatëse, e cila i shqyrton të gjitha kërkesat e palëve dhe i kanë mjetet. Nëse, është e nevojshme ta njoftojnë Kuvendin, atëherë Drejtoritë duhet të vijnë me një rekomandim në mbledhjen e Kuvendit. Ndërsa, kërkesat të cilat nuk duhet ti paraqesin në Kuvend, Drejtoritë i shqyrtojnë vetë dhe ju japin përgjegje. Përndryshe, gjithçka është e ligjshme dhe është në rregullë.

**Sami Ahmeti** – Shumë herë kërkesat e caktuara po shkojnë direkt, që kam edhe shembuj se po shkojnë direkt. Unë i kuptoj kërkesat e Kryetarit, Kryetari është organ që na drejtohet dhe ato kërkesa duhet të shqyrtohen. Mirëpo, edhe të qytetarëve ka herë që për disa po krijohen standarde të dyfishta, e disa kërkesa po shkojnë dhe po trajtohen në Kuvend, në ndërkohë që kërkesat tjera, po iu drejtohen Drejtorive. Unë jam dakord, po e them prapë dhe e di komplet Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, e di qysh funksionon megjithatë ne si Kuvend komunal kur na orientohet diçka, qëllimi është kur shkruan lartë për Kuvendin komunal. Mirëpo, ju po ia drejtoni këtë kërkesë drejtorit, që mendoj se është e paligjshme, nuk është në rregullë në aspektin ligjor, po them mendoj, nuk jam i sigurtë.

**Enver Gashi** – Dua të japë një sqarim se qytetari nuk e din dhe nuk është i njoftuar saktë se qysh shkojnë kërkesat. Është traditë se kërkesat i drejtohen veç Kuvendit komunal, dhe Kuvendi është ai që ose i trajton, ose në shumicën e rasteve i drejton te Drejtoritë përkatëse. Ne në Kuvend jemi marrë vesh që të gjitha kërkesat e qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me Drejtoritë e caktuara të orientohen së pari në Drejtorin e cila pastaj e bën rekomandimin. Mirëpo, ka mjaft kërkesa që nuk kanë nevojë me ardhë fare, janë të pa baza dhe Drejtorin e gjen anën ligjore, ose i kryen vetë, ose i anulon.

**Kryesuesja** - Kërkesat që janë me urgjencë, siç ka qenë peticioni i gurëthyesit drejtorët janë ftuar me urgjencë dhe kanë dhënë sqarime. Unë kërkesën e sindikatës, e rekomandova te DEFZH-ja, dhe ajo Drejtorin duhet me na ardhë me një përgjegje në Kuvend, nëse, ka mjete të mjaftueshme. Po ashtu, për kërkesën e Ganimete Aliut, është Komisioni i formuar prej Kuvendit dhe të gjitha rrugët që emërtohen patjetër se do të vijnë në Kuvend dhe ne do ti votojmë në Kuvend.

#### **Pika 12 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti njoftimin nga z.Jeton Mjekiqi, anëtar i Kuvendit komunal i cili dorëhiqet nga Komisioni i aksionarëve për arsye personale.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 4 vota për dhe 1 votë abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-4, i dt.24.12.2021, për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” pas njoftimit mbi dorëheqjen e z.Jeton Mjekiqi, anëtar i këtij Komisioni.



**Kryesuesja** – Po ashtu, kam një njoftim nga drejtori i DPUKP-së, z.Arben Berisha, për z.Ahmeti. Pas shqyrtimit të emailit zyrtar lidhur me kërkesën për operatorët ekonomik ju njoftojmë se operatorët ekonomik “Alco beton” dhe “Terrastone” nuk posedojnë leje ndërtimore. Operatori ekonomik “Apollonia” sh.p.k. është fabrikë e bllokave, e cila ndodhet në zonën industriale në Llazarevë dhe posedon leje ndërtimore. Ndërsa, sa i përket bazës së asfaltit në Milloshevë, të specifikohet nga ana juaj se për cilën bazë të asfaltit bëhet fjalë.

**Sami Ahmeti** – Ju falenderoj për përgjegjet, sigurisht se drejtori do të jetë në seancën e Kuvendit dhe pastaj do ti vazhdojmë pyetjet tona. Në këtë fazë nuk do të bisedojmë, por do të bisedojmë në seancë nëse, na jepet mundësia. Unë e kam një kërkesë për këtë formë të sallës së Kuvendit dhe ndoshta, është pa lidhje kjo që po e them, por në të gjitha Kuvendet krijohet një vend i mjaftueshëm për drejtorët, që besoj se është edhe respekt për ata dhe punën e tyre. Le ti kemi përpara dhe le ti kemi edhe në nivelin e përgjegjësisë, disi qysh i keni lënë prapa pak pa lidhje po më duket.

**Ibush Mjekiqi** – Sqaron se ka kohë që është mendue edhe projekti për riorganizim të kësaj salle dhe të jeni të bindur se kjo deri më tash kishte me u krye, por për shkak të procedurave të Prokurimit ka mbetë. Mendoj se nëse, nuk mund të kryhet në këtë vit, atëherë në vitin tjetër patjetër do të jetë e rregulluar.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:38'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

